



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
DREJTORIA JURIDIKE DHE E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

UDHËZUES

“Mbi praktikat më të mira në rastet e zbatimit të procedurave të kontrollit të përqendrimeve.”¹

1. Fusha e zbatimit dhe qëllimi i udhëzuesit

1. Qëllimi i këtij akti nënligjor, është të sigurojë udhëzime për palët e interesuara, lidhur me procedurat e kontrollit të përqendrimeve. Udhëzuesi ka për qëllim të nxisë dhe të krijojë një frymë bashkëpunimi dhe mirëkuptimi më të mirë, midis Autoritetit të Konkurrencës (AK) dhe komunitetit ligjor dhe atij të biznesit. Udhëzuesi synon të udhëzojë lidhur me procesin hetimor dhe në këtë mënyrë të rrisë më tej efikasitetin e hetimeve gjatë procedurave të kontrollit të përqendrimeve dhe të sigurojë një shkallë të lartë të transparencës dhe vijueshmërisë së procesit të rishikimit. Në veçanti, synon të bëjë sa më produktive dhe efikase, kohën e shkurtër përpara i përket procedurave të kontrollit të përqendrimeve, për të gjitha palët e interesuara.

2. Paranjoftimi

-Qëllimi i kontakteve të para-njoftimit

2. Faza e para-njoftimit në procedurat e kontrollit të përqendrimeve, është një pjesë e rëndësishme e të gjithë procesit të rishikimit. Si rregull i përgjithshëm, është i rëndësishëm fakti që AK të ketë kontakte para njoftimit me palët njoftuese, edhe në rastet në dukje jo-problematike. Prandaj, AK gjithmonë do t'u japë mundësinë palëve njoftuese dhe palëve të tjera të përfshira, nëse ata kërkojnë, për të diskutuar lidhur me një përqendrim të mundshëm informalisht dhe në mirëbesim, para njoftimit përfundimtar.
3. Kontaktet e para-njoftimit i sigurojnë AK dhe palëve njoftuese mundësinë e para njoftimit, për të diskutuar çështje juridiksionale dhe çështje të tjera ligjore. Ato shërbejnë gjithashtu për të diskutuar çështje të tjera të tilla si qëllimi i informacionit që do të paraqitet dhe për t'u përgatitur për procedurat e hetimit të ardhshëm nga ana e AK, duke

¹DG Competition best practices on the conduct of the EC Merger Control Proceedings / Udhëzim “Praktikat më të mira për procedurat e kontrollit të përqendrimeve”.

identifikuar çështjet kryesore dhe shqetësimet e mundshme të konkurrencës në një fazë të hershme.

4. Për më tepër, është në interes të AK dhe komunitetit të biznesit dhe përfaqësuesve ligjorë, që të sigurohen se formularët e njoftimit janë të kompletuar, të plotësuar që nga fillimi, në mënyrë që deklaratat e pa-plotësisë të shmangen sa më shumë që të jetë e mundur. Për këtë arsye, rekomandohet që palët njoftuese të kontaktojnë AK para njoftimit përfundimtar.
5. Diskutimet lidhur me para-njoftimin zhvillohen në mënyrë konfidenciale. Diskutimet janë pjesë vullnetare e procesit dhe bëhen pjesë e çështjes dhe hetimit të rastit pas njoftimit përfundimtar formal. Sidoqoftë, përfitimet e ndërsjella për AK dhe palët në një fazë të frytshme të para-njoftimit mund të materializohen, vetëm nëse diskutimet zhvillohen në një atmosferë të hapur dhe bashkëpunuese, ku të gjitha çështjet e mundshme trajtohen në një mënyrë konstruktive.
6. Zakonisht është e preferueshme që si këshilltarët ligjorë ashtu edhe përfaqësuesit e biznesit, të cilët i kuptojnë shumë mirë tregjet përkatëse, të jenë në dispozicion për diskutime lidhur me para-njoftimin, me përfaqësuesit e AK që do të merren me rastin. Kjo normalisht rezulton në diskutime lidhur me transaksionin dhe funksionimin e tregjeve në fjalë.

-Koha dhe shtrirja e kontakteve të para njoftimit

7. Kontaktet gjatë para njoftimit, preferohet të fillojnë të paktën dy javë para datës së pritshme të njoftimit formal. Shkalla dhe formati i kërkuar i kontakteve gjatë para njoftimit, lidhet me kompleksitetin e çështjes në fjalë. Në raste më komplekse, një periudhë më e zgjatur e para njoftimit mund të jetë e përshtatshme dhe në interes të palëve njoftuese. Në të gjitha rastet, është e këshillueshme që të kontaktohet me AK sa më shpejt të jetë e mundur, pasi kjo do të lehtësojë planifikimin e rastit.
8. Kontaktet gjatë para-njoftimit duhet të fillojnë me një paraqitje, që lejon zgjedhjen e një grupi pune/ekipi të duhur që do merret me rastin nga ana e AK. Në çdo rast, mund të ketë një paraqitje të shkurtër të transaksionit, një përshkrim të shkurtër të sektorit përkatës dhe tregut (tregjeve) të përfshirë dhe ndikimin e mundshëm të transaksionit në konkurrencë, në terma të përgjithshëm.
9. Pasi të jenë kryer kontaktet fillestare midis grupit të punës/ekipit të çështjes/rastit nga ana e AK dhe palëve njoftuese, do të vendoset, nëse do të mjaftonte që AK të bënte komente verbale ose me shkrim mbi parashtrirat e bëra. Kjo zakonisht kryhet në raste të qarta/të thjeshta/të drejtpërdrejta. Në raste më komplekse dhe çështje që ngrenë çështje

juridiksionale ose çështje të tjera procedurale, një ose më shumë takime gjatë para njoftimit, normalisht konsiderohen të përshtatshme.

10. Takimi i parë gjatë para-njoftimit, normalisht mbahet në bazë të një paraqitjeje më thelbësore ose të një drafti të parë të formularit. Kjo lejon të kryhet një diskutim më i frytshëm në lidhje me transaksionin e propozuar në fjalë ose çështjen e mundshme. Takimet pasuese mund të mbulojnë informacione shtesë.
11. Çdo depozitim pranë AK, kryhet përpara takimeve ose kontakteve të tjera në mënyrë që të lejojë kryerjen e diskutimeve të përgatitura mirë dhe të frytshme. Në këtë drejtim, materialet përgatitore të informimit / drafti i formularëve të dërguar në përgatitjen e takimeve duhet të paraqiten në kohën e duhur para takimit (të paktën tre ditë pune) përveç rasteve nëse bihet dakord ndryshe me grupin e punës/ekipin e AK që merret me rastin. Në rast të paraqitjes voluminoze të dokumentacioneve dhe në rastet jo të qarta/problematike, kjo kohë mund të zgjatet për ti lejuar AK të përgatitet siç duhet për takimin.
12. Pavarësisht nëse takimet gjatë para njoftimit janë zhvilluar ose jo, këshillohet që palët njoftuese të sigurojnë sistematikisht një draft të plotë të formularit, përpara se të paraqesin një njoftim zyrtar. Pas kësaj, AK normalisht do të kërkojë disa ditë pune për të shqyrtuar draftin, përpara se të kërkojë të komentojë, në një takim ose në telefon, mbi përshtatshmërinë e draftit. Në rast të paraqitjeve voluminoze të dokumenteve, kjo kohë normalisht do të zgjatet.

-Informacioni që do të depozitohet / përgatitja e formularit

13. Formatit dhe koha e të gjitha parashtrësive/depozitimeve për para-njoftim, duhet të përcaktohen së bashku me ekipin e AK që merret me rastin. Palët njoftuese këshillohen të depozitojnë plotësisht dhe në mënyrë të saktë informacionin në lidhje me të gjitha tregjet e prekura potencialisht dhe shqetësimet e mundshme të konkurrencës, edhe nëse mund të konsiderohet se nuk prekin konkurrencën apo nëse kanë një këndvështrim tjetër psh në lidhje me përcaktimin e tregut përkatës. Kjo lejon kryerjen edhe të një testi të hershëm të përcaktimit alternativ të tregut dhe / ose pozicionit të palëve njoftuese në tregun / et në fjalë. Kjo qasje minimizon depozitimet e informacioneve të papritura nga palët e treta dhe mund të shmangë kërkesat për informacion shtesë për palët njoftuese në një fazë të vonë të procedurës dhe deklaratat e mundshme lidhur me dokumentacion jo të plotë.
14. Për më tepër, AK rekomandon që palët njoftuese duhet, sa më shpejt që të jetë e mundur, në fazën e para-njoftimit, të paraqesin dokumente të brendshëm si prezantime të bordit, sondazhe, analiza, raporte dhe studime që diskutojnë përqendrimin e propozuar,

arsyetimin ekonomik të përqendrimit dhe rëndësinë që ka konkurrenca apo kontekstin e tregut në të cilin ndodh përqendrimi. Dokumente të tilla i sigurojnë AK një panoramë të hershme dhe informuese të transaksionit dhe ndikimit të saj të mundshëm konkurrues dhe kështu mund të lejojnë një diskutim produktiv dhe finalizues për formularin e njoftimit.

15. Kur është e përshtatshme, rekomandohet gjithashtu që palët njoftuese të paraqesin, tashmë në fazën e para-njoftimit, çdo element që demonstroi se përqendrimi çon në përfitime të efikasitetit, që ata do të dëshironin që AK të merrte parasysh gjatë vlerësimit të konkurrencës të transaksionit të propozuar. Pretendime të tilla, ka të ngjarë të kërkojnë analiza të gjera. Prandaj, është në interesin e palëve njoftuese të paraqesin këto pretendime sa më shpejt të jetë e mundur, për të dhënë kohë të mjaftueshme AK të marrë parasysh këto elemente në vlerësimin që i bëhet një transaksioni të propozuar.
16. Diskutimet gjatë para njoftimit, i japin mundësinë AK dhe palëve njoftuese të diskutojnë sasinë e informacionit që do të depozitohet në një njoftim. Palët njoftuese mund të kërkojnë që në fazën e para-njoftimit, AK të mos të kërkojë informacione të caktuara që nuk janë të nevojshme për shqyrtimin e çështjes. Të gjitha kërkesat për të hequr ndonjë pjesë të informacionit të specifikuar, duhet të diskutohen në detaje dhe të bihet dakord midis AK para njoftimit përfundimtar.

-Plotësimi i formularit të njoftimit

17. Duke pasur parasysh, që një njoftim nuk konsiderohet efektiv derisa informacioni të depozitohet sipas formatit dhe formularit të njoftimit, i cili të jetë i plotë në të gjitha aspektet materiale, palët njoftuese dhe këshilltarët e tyre duhet të sigurohen që informacioni i përfshirë në Formularin e Njoftimit, të jetë përgatitur dhe verifikuar me kujdes: informacioni i pasaktë dhe mashtrues konsiderohet informacion i paplotë. Në këtë drejtim, palët njoftuese duhet të kenë kujdes të veçantë që të sigurohen detajet e duhura të kontaktit për klientët, furnitorët dhe konkurrentët. Nëse një informacion i tillë nuk është i saktë ose i dhënë plotësisht, ai do të vonojë ndjeshëm procedurat e hetimit në rastet e procedurave të kontrollit të përqendrimeve dhe për këtë arsye mund të çojë në një deklaratë të pa-plotësisë.
18. Për më tepër, për të lehtësuar trajtimin efektiv dhe të shpejtë të njoftimit të tyre, palët njoftuese gjithashtu duhet të përpiqen të sigurojnë detajet e kontaktit të kërkuara në Formularin e Njoftimit në mënyrë elektronike, më së voni në ditën e njoftimit, duke përdorur formën e duhur elektronike që mund të sigurohet nga grupi i punës/ekipi që shqyrton rastin.

19. Me kusht që palët njoftuese të ndjekin udhëzimet e përshkruara më sipër, AK në parim, do të jetë i përgatitur për të konfirmuar jozyrtarisht përshtatshmërinë e një draft njoftimi në fazën e para-njoftimit ose, nëse është e përshtatshme, të identifikojë se në çfarë materiali drafti i Formularit të Njoftimit është jo i plotë. Sidoqoftë, duhet të pranohet se nuk është e mundur që AK të përjashtojë faktin që mund të deklarojë një njoftim jo të plotë në rastet e duhura pas njoftimit.
20. Në rast se AK zbulon informacione jo të përfshira në Formularin e Njoftimit, pas njoftimit zyrtar, palëve njoftuese mund t'u jepet një mundësi për të korrigjuar me urgjencë këto mangëse, përpara se të miratohet se njoftimi është i paplotë. Për shkak të kufizimeve kohore në procedurat e përqëndrimeve, koha e lejuar për një korrigjim të tillë normalisht është e kufizuar. Kjo mundësi nuk do të jepet, megjithatë, në rastet kur AK konstaton se mos depozitimi i këtyre informacioneve menjëherë, pengon hetimin e duhur të transaksionit të propozuar.

4. Grumbullimi i fakteve / Kërkesa për informacion

21. Gjatë kryerjes së aktivitetit të tij, AK mund të marrë të gjithë informacionin e nevojshëm nga personat përkatës, ndërmarrjet, shoqatat/bashkimet e ndërmarrjeve dhe institucione të tjera. Ky hetim normalisht fillon pas njoftimit të një përqëndrimi të propozuar. AK mund të vendosë përjashtimisht që, në interes të hetimit, të marrë kontakte paraprakisht me pjesëmarrësit në treg, jo zyrtarisht edhe para njoftimit. Kontaktet / kërkesa të tilla gjatë para njoftimit do të kryhen vetëm nëse ekzistenca e transaksionit është në interesin publik dhe pasi palët njoftuese të kenë pasur mundësinë të shprehin pikëpamjet e tyre mbi këto nisma.
22. Hetimi i AK kryhet kryesisht në formën e kërkesave për informacion, në formë shkresore, për klientët, furnitorët, konkurrentët dhe palët e tjera përkatëse. Kërkesa të tilla mund t'u drejtohen edhe palëve njoftuese. Përveç kërkesave mund të kërkohen edhe pikëpamjet e palëve njoftuese, palëve të tjera të përfshira dhe palëve të treta.
23. Në interes të një hetimi efikas, AK mund të konsultohet me palët njoftuese, palët e tjera të përfshira ose pale të treta për çështje metodologjike në lidhje me mbledhjen e të dhënave dhe informacione në sektorin përkatës ekonomik. Ai gjithashtu mund të kërkojë ekspertizë të jashtme ekonomike dhe / ose industriale dhe të kryejë studime të veta ekonomike.

5. Komunikimi dhe takimet me palët njoftuese, palët e tjera të përfshira dhe pale të treta.

24. Një nga qëllimet e këtij udhëzimi është të rrisë transparencën në trajtimin që i bëhet kontrollit të përqëndrimeve dhe në veçanti, për të siguruar një komunikim të mirë midis AK, palëve që përqëndrohen dhe palëve të treta. Në këtë drejtim AK përpiqet t'u japë të

gjitha palëve të përfshira në procedurë mundësi të mjaftueshme për diskutime të hapura dhe të sinqerta dhe për të bërë të njohur pikëpamjet e tyre gjatë gjithë procedurës.

5.1 Takimet me palët njoftuese

-Qëllimi dhe formati i takimeve

25. Objektivi i takimeve është të kontribuojë në cilësinë dhe efikasitetin e procesit vendimmarrës dhe që të sigurojnë transparencë dhe komunikim ndërmjet AK dhe palëve njoftuese. Si të tilla, këto takime ofrojnë një shkëmbim informacioni të përbashkët ndërmjet AK dhe palëve njoftuese si një pikë kyçe në procedurat që ndiqen. Këto takime janë tërësisht vullnetare.
26. Këto takime mund të kryhen në ambientet e AK ose në mënyrë alternative nëpërmjet telefonit ose video konferencës. Me qëllim që këto takime të jenë të frytshme duhet të përgatiten me kujdes mbi baza të një axhende të miratuar paraprakisht. Përfaqësues të AK drejtojnë këto takime.
27. Në këto takime nuk përjashtohen diskutime dhe shkëmbimi i informacionit ndërmjet palëve njoftuese dhe AK. Palët njoftuese këshillohen të njoftojnë AK sa më shpejt të jetë e mundur në lidhje me ndonjë zhvillim të rëndësishëm procedural ose substancial që mund të ketë rëndësi për vlerësimin e transaksionit të propozuar. Zhvillime të tilla mund të përfshijnë edhe propozime lidhur me kushte dhe detyrime /masa që palët njoftuese ofrojnë ose po marrin në konsideratë që të ofrojnë edhe në juridiksione të tjera, me qëllim që të lehtësojnë koordinimin në kohë të këtyre propozimeve. Kjo gjithashtu mund të përfshijë edhe shqetësime të diskutuara tashmë në këto takime, shqetësime të cilat palët i konsiderojnë të rëndësishëm për të depozituar komente të tjera shtesë.

-Koha e organizimit të takimeve

28. Palët njoftuese normalisht do të ofrojnë mundësinë e marrjes pjesë në takime në pesë momente të ndryshme përgjatë fazës 1 (procedura paraprake) dhe fazës 2 (procedura e thelluar):
 - a) Kur shfaqen “dyshime të arsyeshme” lidhur me një përqendrim, mund të organizohet një takim, me qëllim që të njoftohen palët lidhur me rezultatet paraprake. Takimi ofron një mundësi për palët njoftuese që të përgatisin formulime të mundshme të propozimeve lidhur me kushte dhe detyrime/masa në fazën e parë (procedurën paraprake) përpara përfundimit të afateve kohore të përcaktuara .
 - b) Në rastet kur pritet të merret një vendim lidhur me shfaqjen e shenjave të kufizimit të konkurrencës (“dyshime të arsyeshme”), mund të organizohet një takim. Me qëllim që të përgatiten për takimin, palët njoftuese duhet ti sigurojnë AK informacionin e duhur dhe

çdo dokument përkatës, me shkrim, përpara organizimit të takimit. Arsyeja kryesore e këtij takimi është ti mundësojë palëve njoftuese me njohjen e shqetësimeve të ngritura nga AK në një fazë të hershme gjatë fazës 2 (Procedurës së Thelluar). Takimi gjithashtu shërben që të asistojë AK në përcaktimin e linjës së duhur të hetimeve të mëtejshme, duke diskutuar me palët njoftuese çështje të tilla si përcaktimi i tregut dhe shqetësime të evidentuara të konkurrencës. Takimi gjithashtu shërben me qëllim të informohet çdo palë lidhur me studime ekonomike të planifikuara ose të tjera.

- c) Përpara nxjerrjes/dërgimit të Raportit të Hetimit lidhur me Procedurën e Kontrollit të Përqendrimit. Ky takim përpara nxjerrjes dhe dërgimit të Raportit Përfundimtar i ofron palëve njoftuese, mundësinë që të kuptojnë pozicionin e AK pasi ka marrë në konsideratë përgjigjet e palët njoftuese dhe i ka dëgjuar palët njoftuese në seancën dëgjimore. Nëse AK do të vijojë të mbajë në konsideratë një ose disa nga objeksionet e tij, ky takim mund të shërbejë si një mundësi për të diskutuar qëllimin dhe kohën e propozimeve të mundshme të kushteve dhe detyrimeve/masave që parashikohen të merren.
- d) Para mbledhjes së Komisionit të Konkurrencës. Qëllimi kryesor i këtij takimi është ti mundësojë palëve njoftuese që të diskutojnë lidhur me këndvështrimet e tyre dhe masat e propozuara dhe kur është e mundur, rezultatet e testimit të tregut lidhur me këto masa. Gjithashtu do tu sigurojë palëve njoftuese kur është e nevojshme, mundësinë që të formulojnë dhe paraqesin përmirësime të mëtejshme të masave të propozuara.

5.2. Përfshirja e palëve të treta

- 29. Palët e treta, që konsiderohen se kanë një “interes të mjaftueshëm” lidhur me një procedurë/transaksion përfshijnë klientët, furnizuesit, konkurrentët, anëtarët e administratës ose organet menaxhuese të ndërmarrjes në fjalë ose përfaqësuesit e punonjësve të ndërmarrjeve, në përputhje me nenin 19 të Rregullores “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”. Gjithashtu, Autoriteti mirëpret edhe komentet dhe këndvështrimet e palëve të treta të interesuara përfshirë edhe organizatat e mbrojtjes së konsumatorëve.
- 30. Mënyra kryesore se si palët e treta të interesuara kontribuojnë në procedurat hetimore të Autoritetit është nëpërmjet përgjigjeve që ju kthejnë kërkesave për informacion. Sidoqoftë, AK mirëpret edhe çdo depozitim individual pavarësisht nga përgjigjja e drejtpërdrejtë që i jepet pyetësorit, ku palë të treta ofrojnë informacion dhe komente që i konsiderojnë të përshtatshme për vlerësimin e transaksionit. Autoriteti gjithashtu fton palët e treta në takime për të diskutuar dhe për të sqaruar çështje të ndryshme që ngrihen.
- 31. Autoriteti mundet, kur është në interes të një procedure hetimore, në raste të caktuara, ti sigurojmë një pale të tretë të interesuar e cila ka treguar interes të mjaftueshëm për një

procedure, një version të edituar të Raportit të Hetimit, në të cilin janë hequr sekretet e biznesit me qëllim që tu lejojë atyre që të paraqesin pikëpamjet e tyre lidhur me vlerësimin e Autoritetit. Në të tilla raste, raporti i hetimit jepet nën detyrime strikt të ruajtjes së konfidencialitetit dhe kufizimit të përdorimit, rregulla të cilat palët e treta janë të detyruara që ti pranojnë para marrjes së raportit të hetimit.

32. Nëse palë e treta duan të shprehin shqetësimet e tyre lidhur me konkurrencën lidhur me transaksionin ose të paraqesin këndvështrime në lidhje me të dhënat kyç të tregut apo karakteristika të cilat devijojnë nga pozicioni i palëve njoftuese, është thelbësore që këto këndvështrime të depozitohen sa më shpejt të jetë e mundur pranë AK, në mënyrë që ato të merren në konsideratë, të verifikohen apo të merren parasysh në mënyrën e duhur. Çdo argument i ngritur duhet të jetë thelbësor dhe i mbështetur nga shembuj, dokumente ose të dhëna të tjera faktuale. Gjithashtu, palët e treta duhet të dorëzojnë pranë AK një version jo-konfidencial të informacionit të depozituar me qëllim që të lehtësohet aksesimi në dosje dhe të sigurohet transparenca lidhur me procesin vendimmarrës.

5.3. Takime trepalëshe dhe mbledhje/takime të tjera

33. Përveç takimeve bilaterale ndërmjet AK dhe palëve njoftuese, palë të tjera të përfshira ose palë të treta, AK mund të vendosë që të ftojë edhe palë të treta dhe palët njoftuese në një takim trepalësh ku AK beson se është i nevojshëm dhe një takim i dëshiruar, në interes të hetimit dhe investigimeve për gjetjen e fakteve dhe të informacionit, që të dëgjojnë këndvështrimin e palëve njoftuese dhe të këtyre palëve të treta në një forum të vetëm. Një takim i tillë trepalësh, i cili mund të jetë edhe mbi baza vullnetare dhe që nuk ka për synim që të zëvendësojë seancat dëgjimore formale, do të kryhen në situata ku dy ose më shumë këndvështrime janë paraqitur në lidhje me të dhënat kryesore të tregut dhe karakteristikat e tregut dhe të efekteve mbi konkurrencën që sjell përqendrimi në tregjet përkatëse.
34. Takimet trepalëshe normalisht duhet të zhvillohen sa më herët gjatë fazës hetimore në mënyrë që ti mundësojë AK që të arrijë një konkluzion sa më të qartë lidhur me karakteristikat e tregut dhe të sqarojë çështje thelbësore para se të vendosi për hartimin e Raportit Përfundimtar të Hetimit lidhur me këtë procedurë kontrolli përqendrimi. Zakonisht këto takime trepalëshe kryesohen nga një zyrtar drejtues i AK. Ata përgatiten paraprakisht duke u bazuar në një axhendë takimi, të përgatitur nga AK pasi janë konsultuar me të gjitha palët që kanë rënë dakord të marrin pjesë në takim. Kjo përgatitje normalisht do të përfshijë edhe një shkëmbim të përbashkët të informacionit jo konfidencial ndërmjet palëve njoftuese dhe palëve të treta në fjalë, mjaftueshmërisht paraprakisht në kohë. Në takim nuk do të kërkohet zbulimi i informacionit konfidencial ose i sekreteve të biznesit, përveçse kur është rënë dakord me palët.

6. Diskutimet lidhur me masat/kushtet dhe detyrimet

35. Siç është përmendur më parë, takimet e zhvilluara si në fazën e parë edhe në fazën e dytë, përveçse sigurojnë mundësinë për të diskutuar çështje lidhur me hetimin e këtij rasti të kontrollit të përqendrimeve, gjithashtu shërben si një mundësi për të diskutuar lidhur me propozimet e mundshme për masat, kushtet dhe detyrimet. Në Udhëzimin “Për kushtet dhe detyrimet në rastet e përqendrimeve”, jepen detaje dhe udhëzime lidhur me procedurat që ndiqen në një rast të tillë. Në këtë udhëzim jepen parimet e përgjithshme që aplikohen në rastet e kushteve dhe detyrimeve, llojet kryesore të tyre, kërkesat specifike që duhet të plotësojnë propozimet e këtyre kushteve dhe detyrimeve në të dy fazat e procedurës, dhe udhëzime lidhur me implementimin/zbatimin e këtyre kushteve dhe detyrimeve.
36. Megjithëse, është përgjegjësi e palëve njoftuese që të formulojnë propozime lidhur me kushte dhe detyrime të përshtatshme, AK mund të ofrojë udhëzime për palët edhe lidhur me përshtatshmërinë e përgjithshme të draft propozimeve, përpara se këto propozime të depozitohen. Me qëllim që të lejohen këto diskutime, një palë njoftuese duhet të kontaktojë AK përpara se të përfundojnë afatet kohore të fazës së parë dhe të fazës së dytë, me qëllim që të jetë në gjendje që të adresojnë pretendime lidhur me komentet që AK mund të ketë lidhur me draft propozimet.

7. Përmbajtja e dokumenteve në dosjen e AK/Konfidencialiteti

7.1. Aksesi/qasja në dosje

37. Palët njoftuese kanë të drejtën, bazuar në një kërkesë më shkrim, që të aksesojnë dosjen e AK pasi AK ka dërguar Raportin e Hetimit lidhur me kontrollin e përqendrimeve.
38. Aksesi në dosje duhet të sigurojë mbrojtjen e sekreteve të biznesit të palëve të treta dhe çdo lloji tjetër informacioni konfidencial.

7.2. Rishikimi i dokumenteve kryesore

39. AK mbështet parimin e një shkëmbimi të hapur të këndvështrimeve me mundësi të njëjta për palët njoftuese dhe palët e treta, për ti bërë të ditura këndvështrimet e tyre përgjatë gjithë procedurës. Kjo i mundëson AK që të vlerësojë çështjet kryesore të ngritura përgjatë hetimit, me të gjithë llojin e informacionit që mund të disponojë. Objektivi i AK është tu sigurojë palëve njoftuese mundësinë e rishikimit dhe të komentimit lidhur me dokumentet kryesore që ka AK. Dokumente të tilla do të përfshijnë edhe depozitime të qenësishme të palëve të treta përgjatë fazës së parë, përfshirë depozitime thelbësore dhe studime tregu.

40. AK do tu mundësojë palëve njoftuese, brenda një afati kohor të arsyeshëm me mundësinë e rishikimit këtyre dokumenteve pas fillimit të procedurave. AK do të respektojë edhe kërkesat e justifikuara të palëve të treta për mos zbulimin e depozitimeve të tyre para se të jetë nxjerrë Raporti i Hetimit të procedurës së kontrollit të përqendrimit, lidhur me kërkesa përse i përket konfidencialitetit, mbrojtjes së të drejtave të biznesit, sekreteve të biznesit etj.

7.3. Rregullat e konfidencialitetit

41. AK përgjatë gjithë procedurës hetimore, do të mbrojë informacionin konfidencial dhe sekretet e biznesit që përmban një depozitim informacioni siguruar nga të gjitha palët e përfshira në procedurat e kontrollit të përqendrimeve. Duke pasur parasysh afatet e shkurtra në kohë në lidhje me procedurat hetimore në rastet e përqendrimeve, palët duhet të qartësojnë sa më shpejt të jetë e mundur çdo paqartësi dhe pyetje lidhur me pretendimet për konfidencialitet me anëtarët e grupit të punës.

8. E drejta për tu dëgjuar dhe të drejta të tjera procedurale

42. E drejta për tu dëgjuar, e palëve përkatëse, para se të merret një vendim përfundimtar që ndikon/prek interesat e tyre është një parim themelor që zbatohet. Kjo e drejtë parashikohet si në dispozitat ligjore ashtu edhe në aktet nënligjore në fushën e konkurrencës.

43. Çdo çështje që ngrihet në lidhje me të drejtën për tu dëgjuar apo të drejta të tjera procedurale, përfshirë edhe aksesin në dosje, afatet kohore për tu përgjigjur ndaj Raportit të Hetimit mund të ngrihen gjatë këtyre procedurave të së drejtës për t'u dëgjuar.